
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Nr. ____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) ose

[OE: "E v i t a" SHPK, me Nipt L31714005J dhe adresë: Tirane Rruga Sami Frasheri, Nr. Pasurie 7/120- N1, Zona Kadastrale 8270, Vol. 28, faqe 155.]

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

* * *

Tipi i Kontratës: Mall

Lloji i Procedurës së prokurimit: E Hapur, mbi kufirin e lartë monetar.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF-72884-12-18-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Blerje pajisje mjekësore CT Skanner për Shërbimin e Urgjencave Polivalente" me afat 12 muaj, me fond limit: 67,142,800 (gjashtëdhjetë e shtatë milion e njëqind e dyzetë e dy mijë e tetëqind) Lekë Pa TVSH.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 19.12.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike Buletini Nr. 82 datë 22 Dhjetor 2025

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse, si më poshtë:

1. “E v i t a” SHPK

L31714005J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: **62,450,000** (gjashtëdhjetë e dy milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “ISOMETRIC” SHPK

L92207009A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: **66,680,000** (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. “KONEX” SHPK

L71417022J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: **44,942,810** (dyzet e katër milion e nëntëqind e dyzet e dy mijë e tetëqind e dhjetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. “MEDFAU” SHPK
Emri i plotë i shoqërisë

J93610823R
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: **40,600,000** (dyzet milion e gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. “Medical Distribution” SHPK
Emri i plotë i shoqërisë

L86322004V
Numri i NIPT-it

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: **50,000,000** (pesëdhjetë milion) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “Medical Distribution” SHPK
Emri i plotë i shoqërisë

L86322004V
Numri i NIPT-it

Arsyet : Operatori ekonomik “Medical Distribution” sh.p.k., me NUIS L86322004V nuk i përmbush kërkesat e përgjithshme dhe veçanta për kualifikim të përcaktuara në DT, pasi nuk dorëzoi asnjë document ligjor të kërkuar për tu kualifikuar, ku nuk janë paraqitur dokumentet: Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit, Sigurimi i Ofertës, Pasqyrat Financiare, Xhiro vjetore, Kontratat e ngjashme, Stafë që disponon për realizimin e objektit të kontratës dhe kualifikimet përkatëse, Certifikatat ISO, Certifikatat e Konformitetit të produktit me standartet CE si dhe vetdeklaratat e posacme te kerkuara ne Dokumentat e Tenderit.

Nuk plotëson kërkesat sipas dispozitave ligjore për rregullat e ndërhyrjes në ofertë, pasi Medical Distribution i cili ka marrë pjesë vetë si ofertues (ka paraqitur ofertë ekonomike), ka autorizuar Konnex sh.p.k të paraqese ofertë për produktin printer për filmat radiologjikë, sipas Autorizimit dt 26.05.2026. Në mbështetje të Nenit 81 pika, 1. VKM Nr. 285 dt.19.05.2021 “Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, **do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi**”, MEDICAL DISTRIBUTION sh.p.k s’kualifikohet pasi rezulton me ndërhyrje në ofertë me subjektin tjetër pjesmarrës “KONNEX” sh.p.k., me NUIS L71417022J.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “MEDFAU” SHPK

J93610823R

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet: Operatori ekonomik “MEDFAU” sh.p.k., me NUIS J93610823R nuk i përmbush të gjitha Specifikimet Teknike të aparaturës Skaner CT, të përcaktuara në DT, për këto arsye:

1.Nuk plotëson kërkesat sipas pikave 2.6; 3,5; 4,2; dhe 6.3.5 të “Specifikimeve Teknike” të produktit Skaner CT”, Shtojca 6 të DST, konkretisht:

I. Zëri “Tavolina e Pacientit”, Pika 2,6 e Specifikimeve Teknike

Sipas DST kërkohet: Tavolina e Pacientit: Pika 2.6 “Shpejtësia e lëvizjes së motorizuar të paktën 60 mm/s”.

Ne katalogun “Somatom Go.Tp up” ofrohet:
Shpejtësia e lëvizjes së motorizuar 28,3 mm/s ,

Argumentimi teknik: *Vlera e shpejtësisë të lëvizjes së motorizuar të ofruar 28,3 mm/s, nuk plotëson vlerën minimale të kërkuar 60 mm/s*

II. Zëri **“Gjeneratori dhe Tubi i Rrezeve X”, Pika 3,5** e Specifikimeve Teknike

Sipas DST kërkohet “Gjeneratori dhe Tubi i Rrezeve X”, Pika 3.5 “Kapaciteti nxehtësisë të anodës të paktën 7,5 MHU”.

Ne katalogun “Somatom Go.Tp up” ofrohet:
“Kapaciteti i nxehtësisë të anodës është 7 MHU”

Argumentimi teknik: *Kapaciteti i nxehtësisë të anodës të ofruar 7 MHU, nuk plotëson vlerën minimale të kërkuar të nxehtësisë të anodës 7,5 MHU*

III. Zëri **“Gjeneratori dhe Tubi i Rrezeve X”, Pika 4,2** e Specifikimeve Teknike

Sipas DST kërkohet: “Sistemi i Dedektorëve të CT”, Pika 4.2 “Numri i elementëve të dedektorëve të paktën 70,000(shtatëdhjetë mijë)”

Ne katalogun “Somatom Go.Tp up” ofrohet:
“Numri i elementëve të dedektorëve është 53,760(pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë)”

Argumentimi teknik: *Numri i elementëve të dedektorëve të CT Skaner të ofruara prej 53,760(pesëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë”, nuk plotëson vlerën minimale të kërkuar e dedektorëve 70,000(shtatëdhjetë mijë).*

IV. Zëri **“Njësi kompjuterike me Monitor LCD ”, Pika 6.3.5** e Specifikimeve Teknike

Sipas DST kërkohet: Njësi moderne kompjuterike: Pika 6.3.5 “Shpejtësia e rikonstruksionit për matricë 512X512 me algoritme inerative të avancuara : të paktën 45 imazhe/sekondë)”

Ne katalogun “Somatom Go.Tp up” ofrohet:

“Shpejtësia e rikonstruksionit për matricë 512X512 me algoritme inerative të avancuara është 30 imazhe/sekondë, vlerë më e vogël se vlera minimale e kërkuar 45 imazhe/sekondë).

Argumentimi teknik: *Shpejtësia e rikontsruksionit për matricë 512X512 të ofruar 30 imazhe/sekondë, është vlerë më e vogël se vlera minimale e kërkuar 45 imazhe/sekondë).*

Për sa më sipër Oferta e OE MEDFAU sh.p.k refuzohet, mbështetur në Nenin 92/3 të LPP “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, **vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës**”.

si dhe pikën 18 “Përgjegjshmëria e Ofertave Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë në DST, ku përcaktohet **“Nëse një ofertë nuk i përgjigjet kërkesave të Dokumenteve të Tenderit, ajo refuzohet”.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. “KONEX” SHPK

L71417022J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet: Operatori ekonomik “KONEX” sh.p.k., me NUIS L71417022J nuk i përmbush të gjitha kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në DT, për këto arsye:

1.Nuk plotëson kërkesat sipas pikave 1.5; dhe 2.6 të “Specifikimeve Teknike” të produktit Skaner CT”, Shtojca 6 të DST, dhe konkretisht :

I. Zëri “Pjesa e Jashtme/Gantria”, Pika 1,5 e Specifikimeve Teknike

Sipas DST kërkohet “Pjesa e Jashtme/Gantria”, Pika 1,5 “Të paktën dy kamera të integruara për pozicionimin automatik të pacientit”.

Ne katalogun “UCT 780” ofrohet:

Skeneri përmban Sistemin “UAI Vision 3D Camera”, i cili ndërton imazhe dixhitale në kohë reale të pacientit mbështetur në teknologji AI ,

Argumentimi teknik: Sistemi “UAI Vision 3 D Camera”, i cili ndërton imazhe dixhitale të pacientit mbështetur në teknologji AI, nuk plotëson specifikimin e kërkuara pasi nuk përmban dy kamera të integruara që punojnë në mënyrë të pavaruar për përfitim të imazheve të pacientit.

*Mbi mospërmbushjen e këtij specifikimi nga ofertuesi, KVO sqaron se ky parametër teknik është i detyrueshëm dhe është përcaktuar i pandryshueshëm sipas **Vendimit të KPP Nr.294/2026 dt 23.02.2026**, (vendim që ka trajtuar ankesën mbi kërkesën teknike për dy kamera të integruara të Skanerit)*

Konkretisht në faqen 9 të Vendimit të KPP Nr.294/2026, Komisioni i prokurimit Publik ka cituar përgjigjen e Grupit të Punës të Qendrës Spitalorë Universitare ku argumentohet se: OSUNT ka kërkuar këtë zgjidhje teknologjike, pasi nëpërmjet kësaj zgjidhje teknologjike vendosim pacientin ne pozicionin isocenter dhe nuk është e nevojshme per ta ripozicionuar përsëri, pra duke qene se objekti i prokurimit është skaner për urgjencën polivalente, OSUNT është institucioni më i madh në vend, spitalor, universitar, terciar, ku fluksi i pranimeve në urgjencë është tejet i lartë, dhe në këtë mënyrë nuk humbasim kohe as ne rastet e urgjencave. Dy kamera jane te nevojshme per pozicionimin automatik frontal dhe lateral te pacientit, pasi rrisin konfortin, kontrollin dhe sigurine e pacientit gjate egzaminimit. Pasja e dy kamerave sjell edhe benefite te tjera klinike, si pozicionim automatik isocentrik te pacientit, perftimin e imazheve me te mira, jepet nje diagnoze me e mire, dhe për më tepër, kohe me e shpejte egzaminimi dhe rrjedhimisht perftojme nje performance me te larte klinike. Ky specifikim nuk ndryshon.

Në mënyrë shteruese, në lidhje me kushtin Teknik Pika 1,5 “Të paktën dy kamera të integruara për pozicionimin automatik të pacientit”, ne faqe 50 të Vendimit Nr.294/2026 dt 23.02.2026, KPP ka vendosur:

III.1.11.2. Sa më sipër cituar, KPP konstaton se operatorët ekonomikë ankimues nuk kanë arritur të provojë se në çfarë mënyre specifikimi i kerkuar “Te pakten dy kamera te integruara per pozicionimin automatik te pacientit”, arrin të çënojë konkurrencën dhe të cojnë drejt një prodhuesi të caktuar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës, referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuarit) si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inician procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj.” Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Pesha specifike e barrës për të provuar hartimin e dokumenteve të tenderit në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi është e plotë dhe qëndron mbi pretenduesin, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plotë provues pse kriteret/specifikime teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë të gabuara apo diskriminuese. Nga ana tjetër autoriteti kontraktor ka argumentuar kërkesën

e sipërcituar, pasi sipas tij, nepermjet kësaj zgjidhje teknologjike pacienti vendoset ne pozicionin isocenter, duke shmangur ripozicionimin e tij, në kushtet kur kërkohet skaner per urgjencen polivalente dhe QSUNT eshte institucioni me i madh ne vend, spitalor, universitar, terciar, ku fluksi i pranimeve ne urgjence eshte tejet i larte, ndaj dhe nuk duhet humbur kohe as ne rastet e urgjencave. Pretendimi i ankimuesve nuk qëndron.

V. Zëri “**Tavolina e Pacientit**”, **Pika 2.6** e Specifikimeve Teknike

Sipas DST kërkohet: Tavolina e Pacientit: Pika 2.6 “Shpejtësia e lëvizjes së motorizuar të paktën 60 mm/s”.

Ne katalogun “UCT 780” ofrohet:
Shpejtësia e lëvizjes së motorizuar 40 mm/s ,

Argumentimi teknik: *Vlera e shpejtësisë të lëvizjes së motorizuar të ofruar 40 mm/s, nuk plotëson vlerën minimale të kërkuar 60 mm/s.*

2. Nuk plotëson kërkesat e vecanta për kualifikim sipas pikës 2.2 në lidhje me kapacitetin financiar (xhiro vjetore 2022,2023,2024) pasi nuk vërtetohet me dokumente se ka realizuar xhiro vjetore të paktën për një nga vitet 2022,2023,2024 në vlerën 40% e Fondit limit ose 26, 857,120 lekë, argumentuar

Sipas DST kërkohet: 2.2 *Kapaciteti ekonomik dhe financiar: a) Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vleres e fondit limit të lotit të objektit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Referuar dokumenteve të paraqitura nga subjekti ofertues mbi këtë kusht kualifikuese, rezulton se KONEX sh.p.k ka deklaruar se për vërtetimin e Xhiros Vjetore do të mbështete në kapacitetet e subjektit “Neural ENG” nga Republika e Kosovës. Pas shyrtimit të dokumenteve rezulton se KONEX sh.p.k nuk ka paraqitur Vërtetim për Xhiro Vjetore për subjektin mbështetës “Neural ENG” Kosovë, për vitet 2022,2023,2024, sipas pikës 2.2 germa a) Kerkesat e Vecanta.

Subjekti “Neural ENG”Kosovë ka paraqitur në SPE një dokument me titull “*Formulari i Vetdeklarimit Vjetor dhe Pagesës për Tatiminn në të Ardhurat e Korporatave*”, i cili nuk plotëson kërkesën për kualifikim për këto asrye:

Së pari, ky dokument nuk është dokument i konfirmuar nga Organet Tatimore të Republikës së Kosovës. Sikurse përcaktohet qartë në DST Seksioni F “Vlerësimi i Ofertave” Pika 19

“Kualifikimi i Operatorëve ekonomikë” paragrafi 3, “Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e kërkuar për të gjitha kriteret, për të cilat nuk lejohet vetdeklarim. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. **Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë**”, operatori ekonomik nuk provon se vërtetimi i xhiros nuk lëshohet në vendimin e origjinës Kosove sipas kërkesës në DST. Për këtë operatori i huaj duhet të kishte paraqitur këtë fakt nëpërmjet deklaratës së posacme apo dokumentacionit tjetër provues.

Së dyti “Formulari Vetdeklarimit Vjetor dhe Pagesës për Tatiminn në të Ardhurat e Korporatave” i subjektit “Neural ENG”Kosovë nuk respekton formën ligjore të kërkuar origjinal ose kopje e noteruar përcaktuar qartë në shtojcën 8 e DST paragrafi i fundit : **Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Në konkluzion ofertuesi KONNEX sh.p.k nuk e plotëson e kërkesën për realizimin e xhiros vjetore për vitet 2022,2023,2024, pasi vërteton me dokumentacion se ka realizuar vlerën 20,000,000 lekë në vitin 2024 ndërkohë që duhet te vërtetonte vlerën të paktën 26,857,120 lekë qarkullim xhiro.

3.Nuk plotëson kërkesat sipas dispozitave ligjore për rregullat e ndërhyrjes ne ofertë, pasi KONNEX sh.p.k, figuron pjesmarrës në ofertën e subjektit Medical Distribution i cili ka marrë pjesë vetë si ofertues si dhe ka autorizuar Konnex sh.p.k të paraqese ofertë për produktin printer për filmat radiologjikë, sipas Autorizimit dt 26.05.2026. Në mbështetje të Nenit 81 pika, 1. VKM Nr. 285 dt.19.05.2021 “Pjesëmarrja nga një ofertues në më shumë se një ofertë, tek e tek ose me një ofertues tjetër, **do të rezultojë në përjashtimin nga procesi të të gjitha ofertave, në të cilat është përfshirë ofertuesi**”, KONEX sh.p.k s’kualifikohet pasi rezulton me ndërhyrje në ofertë me subjektin tjetër pjesmarrës “Medical Distribution” sh.p.k., me NUIS L86322004V

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. “ISOMETRIC” SHPK

L92207009A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Arsyet: Operatori ekonomik “ISOMETRIC” sh.p.k., me NUIS L92207009A nuk i përmbush të gjitha Spsecifikimet Teknike të aparaturës Skaner CT, të përcaktuara në DT, për këto arsye:

1.Nuk plotëson kërkesat sipas pikave 1.5 ; 2.6 ; 3,4 ; 4,2; dhe 6.3.5 të “Specifikimeve Teknike” të produktit Skaner CT”, Shtojca 6 të DST, dhe konkretisht :

I. Zëri “**Tavolina e Pacientit**”, **Pika 2,6** e Specifikimeve Teknike

Sipas DST kërkohet: Tavolina e Pacientit: Pika 2.6 “Shpejtësia e lëvizjes së motorizuar të paktën 60 mm/s”.

Ne katalogun “Insitum CT 768” ofrohet:
Shpejtësia e lëvizjes së motorizuar 15 mm/s ,

Argumentimi teknik: *Vlera e shpejtësisë të lëvizjes së motorizuar të ofruar 15 mm/s, nuk plotëson vlerën minimale të kërkuar 60 mm/s*

II. Zëri “**Gjeneratori dhe Tubi i Rrezeve X**”, **Pika 3,4** e Specifikimeve Teknike

Sipas DST kërkohet “Gjeneratori dhe Tubi i Rrezeve X”, Pika 3.4“Madhesia Nominale e pikës fokale të tubit (sipas IEC 60336)”.

Ne katalogun “Insitum CT 768” ofrohet:
“Madhesia Nominale e pikës fokale të tubit (mungon IEC 60336)”.

Argumentimi teknik: *Madhesia Nominale e pikës fokale të tubit nuk përmban standartin IEC 60336 sipas kërkesës në Specifikimet Teknike.*

III. Zëri “**Gjeneratori dhe Tubi i Rrezeve X**”, **Pika 4,2** e Specifikimeve Teknike

IV.

Sipas DST kërkohet: “Sistemi i Dedektorëve të CT”, Pika 4.2 “Numri i elementëve të dedektorëve të paktën 70,000(shtatëdhjetë mijë)”

Ne katalogun “Insitum CT 768” ofrohet:
“Numri i elementëve të dedektorëve është 55,296(pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e nënëtdhjetë e gjashtë ”,

Argumentimi teknik: *Numri i elementëve të dedektorëve të CT Skaner të ofruara prej 55,296(pesëdhjetë e pesë mijë e dyqind e nënëtdhjetë e gjashtë ”, nuk plotëson vlerën minimale të kërkuar e dedektorëve të paktën 70,000(shtaëdhjetë mijë)”*

V. Zëri “**Njësi kompjuterike me Monitor LCD** ”, **Pika 6.3.5** e Specifikimeve Teknike

Sipas DST kërkohet: Njësi moderne kompjuterike: Pika 6.3.5 “Shpejtësia e rikontsruksionit për matricë 512X512 me algoritme iterative të avancuara : të paktën 45 imazhe/sekondë)”

Ne katalogun “Insitum CT 768” ofrohet:

“Shpejtësia e rikontsruksionit për matricë 512X512 me algoritme iterative të avancuara është 40 imazhe/sekondë, vlerë më e vogël se vlera minimale e kërkuar 45 imazhe/sekondë).

Argumentimi teknik: Shpejtësia e rikontsruksionit për matricë 512X512 të ofruar 40 imazhe/sekondë, është vlerë më e vogël se vlera minimale e kërkuar 45 imazhe/sekondë).

VI. Zëri “Pjesa e Jashtme/Gantria”, Pika 1,5 e Specifikimeve Teknike

Sipas DST kërkohet Pjesa e Jashtme/Gantria”, Pika 1,5 “Të paktën dy kamera të integruara për pozicionimin automatik të pacientit”.

Ne katalogun “Insitum CT 768” ofrohet:

Skaneri përmban Sistemin “ 3D Vision Camera”,

Argumentimi teknik: Sistemi “3D Vision Camera”, nuk plotëson specifikimin e kërkuar pasi nuk përmban dy kamera të integruara që punojnë në mënyrë të pavaruar për përfitim e imazheve të pacientit.

2.Nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim sipas pikës 2.3.1”Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e fondit limit të objektit që prokurohet, pasi nuk ka realizuar furnizime të ngjashme me objektin si në përmbajtje ashtu edhe në vlerë.

Konkretisht faturat e paraqitura përmbajnë furnizime në fushën e materialeve laboratorike dhe jo pajisje mjeksore egzaminuese e cila objekti është i prokurimit.

Gjithashtu vlera e realizuar të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, nuk plotëson vlerën e kërkuara prej 40% të fondit limit për furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit.

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i sukseshëm:

1. “E v i t a” SHPK

L31714005J

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave : **62,450,000** (gjashtëdhjetë e dy milion e katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

(e shprehur në shifra dhe në fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Totali i pikëve të marra: Nuk Aplikohet!

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR